



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 334/Prot
5

Tiranë më 01.10, 2015

V E N D I M

Nr. 105, datë 01 / 10 /2015

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil,
Njësia Administrative Nr. 4, Tiranë.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", (i ndryshuar); neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" si dhe Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2014, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Hetimit Administrativ dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me procesin e mbikëqyrjes të zhvilluar në Njësinë Administrative nr. 4, Bashkia Tiranë (*Njësia Bashkiake nr.4, Tiranë*),

VËREJ SE:

Në zbatim të vendimit nr. 38, datë 23.04.2015 "*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Njësia Bashkiake Nr. 4, Tiranë*", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar mbikëqyrjen e përgjithshme në subjektin, Njësia Bashkiake Nr. 4, Tiranë, tashmë njësi administrative e Bashkisë Tiranë.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore, gjatë aplikimit të gjithë instituteve të tij.

Procesi është zhvilluar në përputhje me programin e mbikëqyrjes nr. 334/2 prot., datë 23.04.2015, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe njoftuar institucionit me shkresën nr. 334 prot., datë 23.04.2015 "*Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes*".

Në përfundim të këtij procesi, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të kontrolluar, me shkresën nr. 334/3 prot., datë 30.07.2015, duke i lënë 3 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Ndërkohë, për shkak të riorganizimit administrativo-territorial që kanë pësuar njësitet e qeverisjes vendore, në zbatim të ligjit nr. 30/2015 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar*”, ligjit nr. 115/2014 *“Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”*, njësitet bashkiake, janë organizuar si njësi administrative, struktura dhe organika e të cilave, do të jenë pjesë e strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë.

Në Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitet e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”*, Kreu III, *“Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve”*, pika 1, përcaktohet se bashkia është trashëgimtari ligjor i njësive të qeverisjes vendore që janë shkrire në të, e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ, të njësive të qeverisjes vendore që janë shkrire. Më tej, në Kreun IV të këtij akti nënligjor, *“Transferimi i personelit”*, parashikohet se marrëdhëniet e punës ekzistuese, ndërmjet njësive që janë shkrire dhe punonjësve të tyre, do të transferohen në bashki, në momentin e konstituimit të organeve të saj.

Në këto rrethana të reja, të krijuara për shkak të riorganizimit të njësive të qeverisjes vendore, ky raport me konkluzionet e tij, si dhe vendimi përkatës i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, që paralajmëron institucionin për të përmirësuar situatën, do t'i drejtohen për zbatim njësisë përgjegjëse pranë Bashkisë Tiranë, si institucioni përgjegjës në këtë rast.

Në vijim të korrespondencës gjatë procesit të mbikëqyrjes, nga ana e Njesisë Administrative nr. 4, Tiranë, me shkresën nr. 02/1 prot., datë 06.08.2015, është kthyer projektraporti i pa nënshkruar dhe pa observacione me pretendimin se, Njësia Administrative, nuk është organi kompetent të shprehet për ligjshmërinë, ose jo të administrimit të shërbimit civil, në ish Njësinë Bashkiake nr. 4, Tiranë.

Sa më sipër, kur subjekti i mbikëqyrur është njohur me projektraportin dhe i ka pasur të gjitha mundësitë që të komunikojë me njësinë përgjegjëse pranë Bashkisë Tiranë, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pas shqyrtimit të përmbajtjes së raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës dhe në përfundim të këtij procesi, vlerësoj se duhet të miratojë përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2014, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në subjektin, Njësia Administrative Nr. 4, Tiranë, i cili është pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Tiranë, duhet të kryejë procedurën e deklarimit të statusit të punësimit për nëpunësit dhe punonjësit aktualë, sipas kërkesave të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*
3. Njësia përgjegjëse, si struktura e ngarkuar nga ligji për administrimin e burimeve njerëzore, duhet të fillojë procedurën për revokimin e akteve si më poshtë:
 - Revokimin e aktit administrativ nr. 47, datë 22.09.2014 për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin *“Specialist Finance në Sektorin Ekonomik”* dhe kthimin e tij në pozicionin e mëparshëm, *“Specialist në Zyrën e Ndihmës Ekonomike”*.
 - Revokimin e aktit nr. 13, datë 11.03.2015, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin *“Specialist në Zyrën e Ndihmës Ekonomike”* dhe kthimin e tij në pozicionin e mëparshëm *“Specialist në Zyrën e Urbanistikës”*.

Rekomandohet njësia përgjegjëse e ngarkuar nga ligji për menaxhimin e burimeve njerëzore, që në koherencë me strukturën aktuale të institucionit, vendin e punës *“Specialist Finance në Sektorin Ekonomik”* dhe *“Specialist në Zyrën e Ndihmës Ekonomike”*, t’i shpallë vende të lira, në mënyrë që të plotësohen sipas procedurave të përcaktuara nga ligji.

- Revokimin e aktit administrativ nr. 53, datë 07.10.2014 për emërimin e nëpunëses ***** në detyrën *“Përgjegjëse e Sektorit të Ndihmës Ekonomike”* dhe kthimin e saj në pozicionin e mëparshëm, *“Specialiste në Zyrën e Ndihmës Ekonomike”*.

Rekomandohet njësia përgjegjëse e ngarkuar nga ligji për menaxhimin e burimeve njerëzore, që në koherencë me strukturën aktuale të institucionit, vendin e punës *“Përgjegjës i Sektorit të Ndihmës Ekonomike”*, ta shpalli vend të lirë, në mënyrë që të plotësohet sipas procedurave të përcaktuara nga ligji.

4. Njësia përgjegjëse, të revokojë aktet administrative të emërimit, për punonjësit ***** emëruar në pozicionin e punës *“Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”*; ***** , emëruar në pozicionin *“Specialist i Taksave të Tregut”* dhe ***** ,

emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës Juridike”, duke mos zhvilluar më parë procedurat e konkurrit, ç’ka vjen në kundërshtim me nenin 20 e vijim të Kreut IV “Pranimi në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Pozicionet e punës që mbajnë këta nëpunës, në koherencë me strukturën aktuale të institucionit, të shpallen vende të lira, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Njësia përgjegjëse, për të rregulluar ligjshmërinë në lidhje me marrëdhëniet e punës për nëpunësen ***** të verifikojë procedurën e kryer nga Bashkia Burrel, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, në lidhje me zbatimin e vendimit nr. 6, datë 03.02.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë, pasi nga zbatimi i tij, lindin të drejta dhe detyrime që kanë të bëjnë me pagesën e pagës dhe më tej, vlerësimin e statusit të punësimit të kësaj punonjëseje.
6. Njësia përgjegjëse në Bashkinë Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme dhe Departamentin e Administratës Publike, të qartësojnë pozicionin e nëpunësve të gjendjes civile, në raport me shërbimin civil e pas kësaj, të vijojnë procedurat lidhur me deklarimin e statusit të punësimit për punonjësit e Zyrës së Gjendjes Civile, *****
, pozicioni i punës “Përgjegjës Sektori i Gjendjes Civile”; ** pozicioni i punës “Specialist”; ***** , pozicioni i punës “Specialist”; ***** , pozicioni i punës “Specialist” dhe ***** , pozicioni i punës “Specialist”.
7. Njësia përgjegjëse, të fillojë menjëherë punën për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës, për pozicionet e shërbimit civil, në përputhje me legjislacionin specifik të fushës dhe formatin standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” dhe lidhjes 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.

Në zbatim të rekomandimeve të materializuara në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe me Departamentin e Administratës Publike, të hartohen përshkrimet e punës për pozicionet që i përkasin Zyrës së Gjendjes Civile.

8. Njësia përgjegjëse, të përfshijë administratën e njësisë administrative të mbikëqyrur, në planin vjetor të nevojave për rekrutimin në shërbimin civil, mbi bazën e kërkesave të nenit 18 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil”.
9. Njësia përgjegjëse, në rastet e dorëheqjes së nëpunësit civil, të zbatojë drejt procedurën që duhet të ndiqet, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 64 (Kreu XII “Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil”), për të respektuar të drejtat dhe detyrimet e nëpunësit civil që lindin për shkak të zbatimit të institutit të dorëheqjes.

Të ndreqen aktet e lirimit nga detyra, për punonjësit ***** , në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”; ***** në pozicionin “Specialist Tregjesh” dhe ***** në pozicionin “Juriste”, sipas rekomandimeve në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

10. Njësia përgjegjëse të sistemojë dokumentacionin që tregon për historikun e marrëdhënies së punës me subjektin e mbikëqyrur, të punonjëses ***** dhe të sqarojë situatën në lidhje me masën disiplinore që është dhënë ndaj saj.
11. Njësia përgjegjëse, të kryejë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve për vitin 2014, duke hartuar formularët e vlerësimit të punës, sipas formatit të miratuar dhe në mbështetje të kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “ Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”.

Formulari i plotësuar dhe i nënshkruar nga personat e ngarkuar nga ligji, duhet të depozitohet pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit dhe të futet në dosjen personale të çdo nëpunësi civil.

12. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 60 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim, duke marrë parasysh se zbatimi i tij kërkon një kohë të kushtëzuar nga afatet procedurale të veprimeve që duhet të kryhen në këtë rast për rregullimin e situatës.
13. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim, duke u bazuar në rekomandimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
14. Me kalimin e këtij afati, institucioni është i detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
15. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Tiranë, Njësia Administrative nr. 4, Tiranë; Departamenti i Administratës Publike; Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA